



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 328 prot.

Tiranë, më 05.07.2025

URDHËR

Nr. 171, Datë 05.07.2025

PËR

**MIRATIMIN E PERIUDHËS SË APLIKIMEVE ME FORMULARIN A1Z PËR MATURËN
SHTETËRORE 2025**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006 "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 661, datë 01.12.2023, "Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 1, datë 09.01.2025, "Për organizimin dhe zhvillimin e Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2025", si dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 13.03.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore",

URDHËROJ:

1. Miratimin e periudhës së aplikimeve me formularin A1Z, për MSH 2025, **në datat 14-15 Korrik 2025, ora 08.00 – 16.00.**
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto